

VEEBER kundër ESTONISË (nr. 2)*(kërkesa nr. 45771/99)***21 janar 2003**

në këtë çështje u gjet në kundërshtim me Konventën efekti prapaveprues i së drejtës penale

I. Faktet kryesore

1. Tiit Veeber ka lindur më 1948 dhe jeton në Tartu, Estoni. Ai është pronari i shoqërisë AS Giga dhe kryetar i Bordit të saj. Ai është gjithashtu kryetar i Bordit të shoqërisë AS Tartu Jõujaam.

2. Më 7 tetor 1996, si kryetar i Bordit të këtyre dy shoqërive dhe si pronar i së parës, ai u akuzua në bazë të Nenit 148/1 § 7 të Kodit Penal për falsifikim dhe fabrikim dokumentesh në pesë raste në periudhën 1993-1994 për të treguar marrëdhënie tregtare me një shoqëri të paqenë, për përdorim të dokumenteve të rreme në lidhje me dokumentet e rrogave më 1994 dhe 1995 dhe për lidhjen, më 12 maj 1995, të një kontrate false për të shmangur pagimin e taksave.

3. Më 13 tetor 1997 kërkuesi u gjet fajtor për akuzat të cilat i ishin ngarkuar, dhe iu dha një dënim me burg me kusht prej tre vjet e gjashtë muaj. Në vendimin e dënimit të kërkuesit për shmangie nga detyrimet fiskale në bazë të Nenit 148/1 § 7 të Kodit Penal, gjykata interpretoi se veprat penale kishin filluar të konsumoheshin në tremujorin e katërt të vitit 1993, dhe se vepra e fundit u konsumua më 12 maj 1995. Ajo vlerësoi se këto akte përbënin një vepër penale me karakter vazhdues. Kërkuesi u urdhërua gjithashtu që tu paguante autoriteteve fiskale 853 550 korona estoneze.

4. Kërkuesi e apeloj këtë vendim duke pretenduar se Neni 148/1 § 7 i Kodit Penal kishte pasur efekt prapaveprues, përderisa ai kishte hyrë në fuqi vetëm më 13 janar 1995. Dënime në bazë të këtij Neni, për akte të kryera përpara kësaj date, mund të gjenin vend vetëm nëse personi përgjegjës kishte qenë subjekt i një sanksioni me karakter administrativ ose ishte dënuar penalisht më parë për të njëjtat akte. Por apelimi i tij nuk u pranua.

II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi pretendonte ndërmjet të tjerash, se dënimi i tij përbënte një zbatimin me efekt prapaveprues të një ligji penal, duke shkelur kështu Nenin 7 § 1 të Konventës (nuk ka dënim pa ligj).

A. Në lidhje me Nenin 7 § 1

6. Gjykata e Strasburgut vuri në dukje se një numër i konsiderueshëm aktesh për të cilët kërkuesi u gjet fajtor kishin ndodhur tërësisht përpara janarit 1995, dhe se dënimi që iu dha atij mbante parasysh aktet e kryera si përpara ashtu edhe pas janarit 1995.

7. Gjykata i mori parasysh argumentet e qeverisë estoneze, sipas të cilës jurisprudenca e Gjykatës së Lartë estoneze mbi zbatimin dhe interpretimin e versionit të vitit 1995, të Nenit 148/1 të Kodit Penal, e bënte më se të parashikueshëm dënimin për kërkuesin dhe për çdo të interesuar. Megjithatë, vendimet e Gjykatës së Lartë që ravijëzonin këtë jurisprudencë ishin dhënë vetëm në prill të vitit 1997 dhe janar të vitit 1998. Ankesa e kërkuesit kishte të bënte me akte të kryera ndërmjet viteve 1993 dhe 1994, periudhë gjatë së cilës ai nuk mundej që, duke pasur parasysh legjislacionin penal të zbatueshëm në atë kohë, të parashikonte që rrezikonte një dënim penal sapo të zbuloheshin aktet e tij.

8. Duke konstatuar në bazë të këtij interpretimi që gjykatat estoneze e kishin zbatuar në mënyrë prapavepruese ligjin e vitit 1995 në lidhje me sjellje që më parë nuk përbënin vepra penale, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të Nenit 7 § 1.

B. Në lidhje me Nenin 41

9. Gjykata i akordoi kërkuesit 2 000 euro për dëm jo-material dhe 840.90 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.